



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR EKONOMI DHE ZHVILLIM

Datë:	08.06.2026
Referenca:	
Për :	z. Imri Ahmeti - Kryetar i Komunës së Lipjanit
Kopje :	z. Diamant Bytyqi - Nënkyetar i Komunës
Nga:	z. Valon Pacolli - Drejtor i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim
Lënda:	Raport për muajin Qershor - 2026

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë këtij muaji në Drejtoratin për Ekonomi dhe Zhvillim janë realizuar detyra dhe obligime, si dhe aktivitete që dalin nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, ligjet tjera sektoriale, udhëzimet, urdhëresat, statuti dhe rregulloret tjera komunale si dhe obligime të tjera nga e drejta pozitive në përgjithësi.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUdhës RAPORTUESE

- Funkcionalizimi i rrjetit WIFI falas në sheshin e qytetit
- Organizimi i panairit të produkteve ushqimore dhe artizanale në sheshin e qytetit
- Takime dhe zhvillim të mundësive për bashkëpunim me organizatën HELP Kosova
- Organizim i info sesioneve për projektet në ndërmarrësi për bizneset nga MZHR
- Hapje e thirrjes për trajnim në kuadër të projektit me organizatën Sheikha Fatima
- Kompletimi i dosjes dhe procedimi tutje për fazën e V-të të zhvillimit të zonës ekonomike Qylagë
- Takime me palë të interesuara për investime në Komunën e Lipjanit
- Përgatitje e faturave për shfrytëzuesit e pronës afatshkurtër komunale
- Përgatitje e raporteve mujore për ngarkesat e shfrytëzuesve afatshkurtër të pronave komunale, raporte këto të adresuara Sektorit-Pronësoro Juridik.

STATISTIKAT

KRYERJA E PUNËVE PËR TË CILAT UDHËHIQET PROCEDURË ADMINISTRATIVE
01.06.2026-30.06.2026

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA	SHËNIM
1	Pagesa të bizneseve për ndryshime	8	
2	Biznese të reja të regjistruara	24	
3	Duplikat dhe ndrrim të qertifikatave	5	
4	Kërkesë për ndryshim të adresës	1	
5	Ndryshim i njësisë	0	
6	Vërtetim që nuk posedon biznes	0	
7	Shuarje të biznesit	3	
8	Shtim i aktivitetit të biznesit	2	
9	Informata të bizneseve	29	
10	Ndrrim i pronarit	4	
11	Kërkesë për ndryshim të emrit të biznesit	2	
12	Kërkesë për ndryshim të kapitalit	1	
13	Ndrrim të tipit të biznesit	0	
14	Ndrrim të drejtorit	2	
15	Shtim emaili dhe nr.tel	1	